

# UDHA ISLAMIE

Viti XII - Nr. 7 (137), Korrik, 2014

E përnuajshme Informativ - Fetare - Kulturore - Edukative

Botim i Myftinisë Shkodër

## RAMAZAN LUTJESH PËR GAZËN...



## MYFTIU PRITI KONSULLIN E KUVAJTIT, Z. FAJSAL AL-BAKR



**P**araditën e së dielës, më 29 qershor 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhammed Sytari, priti në një takim të përzemërt e vëllazëror, Konsullin e Shtetit të Kuvajtit në Tiranë, z. Fajsal Al-Bakr.

Qëllimi i kësaj vizite ishte urimi, që Konsulli i Kuvajtit i dorëzoi Myftiut të Shkodrës, me rastin e Muajit të Begatë të Ramazanit, me lutjet më të mira për një adhurim të pranuar dhe mbarësi për të gjithë besimtarët. Ai i përcolli Myftiut edhe selamet dhe urimet e Ambasadorit, z. Najeeb Al-Bader, me rastin e Muajit Ramazan.

Ndërkohë, Myftiu i Shkodrës e ka falënderuar konsullin kuvajtian për këtë vizitë, duke falënderuar njëkohësisht edhe kontributet e dobishme që Ambasada e Shtetit të

Kuvajtit dhe Ambasadori Al-Bader kanë dhënë herë pas here për qytetin e Shkodrës dhe njerëzit në nevojë, duke dëshmuar vullnetin e mirë të vëllazërisë dhe miqësisë në mesin e dy popujve.

Me rastin e kësaj vizite, Konsulli Al-Bakr, ka dorëzuar në Myftininë e Shkodrës një sasi prej 110 pakosh me ndihma ushqimore për besimtarët dhe agjëruesit, duke theksuar se Ambasada e Kuvajtit është e interesuar të ndihmojë dhe të përkrahë njerëzit në nevojë, sidomos në momente të tilla si Muaji Ramazan, begatitë e të cilit përhapen gjithandej.

Një sasi e këtyre pakove, janë shpërndarë nga vetë Konsulli në shoqëri të Myftiut, edhe për "Shtëpinë e Fëmijës", së qytetit Shkodër.



"KUR'ANI  
ËSHTË HARTA  
E LUMTURISË,  
PËR KËTË BOTË  
DHE PËR  
TË PËRTEJMEN.  
NËSE NJERIU  
E HUMBET RRUGËN,  
SE NUK KA HARTË,  
JUSTIFIKOHET.  
PO, KUR E KA  
HARTËN ME VETË  
DHE E HUMBET  
RRUGËN?!"

SHEJKH AHMED KEFTARO,  
1915-2004

# “ELHAMDULIL-LAH”

## “FALËNDERIMI I PLOTË I TAKON VETËM ALL-LLAHUT”!

**M**e nisjen e agjërimit të Muajit Ramazan, muslimani angazhohet që të përmirësojë jetën e tij një mujore, me qëllim vijimësinë në rrugën dhe traditën e begatë të muajit të agjërimit, edhe pas tij. Dashje pa dashje, duke qenë agjërueshëm, disa gjëra shihen me një sy, ndryshe nga 11 muajt e tjerë të rutinës, ku të gjithë, në një mënyrë a një tjetër, bëhemi pjesë e pashmangshme.

Mirëpo, ajo që më silltet ndër mend, teksa mendoj dhe hedh sytë përreth, në ditët dhe netët e këtij muaji ndryshimi pozitiv, është pyetja e mëposhtme: A nuk duhet me e falënderu All-llahun, që na udhëzoi në Islam, vulën e misioneve hyjnore dhe të vetmen Thirrje të shenjtë, me të cilën u dërguan të gjithë të Dërguarit e Tij? Sepse, edhe ne (e kam fjalën për praktikantët e agjërimit dhe rrugëtuesit drejt mirësisë dhe mundësive që ai ofron), mund të ishim njerëz me komplekse islamofobe, që kohët e fundit nuk është e vështirë të identifikohen edhe në vendin tonë, sidomos tash, që bota arabe-islame është bërë si ajo “kafshata” në fjalën profetike, drejt së cilës “egërsirat do të vërsulen” si të babëzitur, në një botë plot hipokrizi e servilizëm..!?

Mund të ishim ateistë, si shumë prej atyre, që vazhdojnë të bëjnë moralin darvinist a frojdian, edhe pse i ka skaduar data dhe është dëshmuar haptas dëmi i tyre për shëndetin psikologjik, shkencor e shpirtëror

të njeriut bashkëkohor..!?

Mund të ishim pijetarë, si shumë sosh, që mbushin tryezat e dala nëpër trotuaret e kalimtarëve, (por jo vetëm), si model imponues dhe shebull dehës, në realitete gjysëm të dehura e gjysëm të hutuara, nëpër të cilat dallgëzohet vendi ynë dhe shoqëria..!?

Mund të ishim si shumë joagjërues të rëndomtë, që me një “pfff”, mundohen të largojnë zamallahinë e temës së agjërimit, me arsyetimin e vapës së stinës,

si veprim”..!?

**Mund të ishim.., shumë “mund të ishim”...**

Por, falë Tij, All-llahu na udhëzoi drejt më të mirës dhe më të përsosurës së mënyrave, me të cilat arrijmë pëlqimin dhe kënaqësinë e Tij në këtë jetë të përkohshme dhe në të përtejmen e pashmangshme.

Na udhëzoi në më logjiken dhe më të suksesshmen e formave të dëshimit tonë si besimtarë dhe njerëz të vendosur për ta jetuar jetën, sipas rregullave dhe moralit të Krijuesit të saj, i qofshim falë! Dhe, për këtë, mjafton me e ndalë pak ritmin e jetës dhe duke marrë frymë thellë, me dëshmu: “Elhamdulillah”: “Falënderimi i plotë i takon vetëm All-llahun”!

Falënderimi më i mirë në këtë realitet udhëzimi, është rrugëtimi drejt Dashnisë dhe Pëlqimit të Tij, duke përsëritur në vazhdimësi: “Ijjake na'budu ve ijjake nestein”: “Ty të adhurojmë dhe (vetëm)

Ty të kërkojmë ndihmë”!

Njëkohësisht, me u lutë, me të njëjtën dashamirësi largpamëse, me të cilën Hz. Muhammedi (a.s) lutej për popullin e Taifit, ditën kur e refuzuan dhe e gjuajtën me gurë, teksa i ftonte drejt udhëzimit dhe Dritës së besimit: “All-llahumme udhëzoje popullin tim, se ata nuk dijnë!”

**Agjërim të mbarë, të dashurit e mi!**

**Imam Muhamed Sytari**  
Myfti i Zonës Shkodër

3 korrik 2014



pamu- ndësinë e ndarjes nga duhani, riska e shalqirit a shishja me ujë të akullt..!?

Mund të ishim jonamazli, prej atyre që këndimi i ezanit, i kalon si një zhurmë më shumë, në një botë të zhurmshme, ku nuk merret vesh se ç'ka vlen e ka dobi e, ç'ka jo..!?

Prej atyre, që shkuarjen në xhami e konsiderojnë si shkak për të hyrë “në gojë të hallkut”, a dëshmi i një identiteti të vjetëruar, që tash me rastin e marrjes së statusit, mund të tingëllojë edhe “më pak evropian

## PROMOVOHET LIBRI: “LEXOJ DHE MËSOJ KUR’AN”

**D**itën e enjte, më 3 korrik 2014, në xhaminë e Parrucës, Myftinia Shkodër ka organizuar në një rreth të ngushtë me imamë, teologë, pedagogë, intelektualë e të rinj muslimanë, promovimin e librit më të ri nga thirrësi islam Lavdrim Hamja, të titulluar: “Lexoj dhe mësoj Kur’an”.

Në fjalën e tij hapëse, teologu Ervil Kuçi ka vënë theksin te rëndësia që ka angazhimi i thirrësve islamë shqiptarë, në pasurimin e jetës fetare dhe bibliotekës islame, sidomos me botime të dobishme, që ofrojnë njohuri dhe dije të reja, të domosdoshme për jetën fetare.

Ndërsa teologu Arben Halluni, në fjalën e tij, ka përshëndetur librin e ri të teologut Lavdrim Hamja, si një libër që përkon edhe me Muajin e Begatë të Ramazanit, në të cilin nisi zbritja e Kur’anit Famëlartë. Ai theksoi se ky libër do të shërbejë më së miri edhe për xhamitë dhe kurset fetare, që Myftinia Shkodër organizon në to, për mësimin e alfabetit të Kur’anit dhe leximin e rrjedhshëm të tij.

Me shumë vëmendje, të pranishmit kanë ndjekur edhe fjalën e autorit, në

të cilën ka treguar shkaqet që e kanë nxitur në përpilimin e këtij libër, në të cilin ka material të bollshëm për mësimin e gjuhës së Kur’anit, rregullat e texhvidit dhe një ndihmë për të gjithë ata që kanë nevojë për një mbështetje në leximin e sureve kryesore dhe xhyzit “Amme”, pjesët e të cilit janë sjellë edhe me shkronjat e alfabetit tonë, krahas origjinalit.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed Sytari, i cili pasi falënderoi autorin e librit për këtë vepër të dobishme, solli në vëmendje të pjesëmarrësve kujtime nga koha e studimeve dhe personazhet e librit të ri, sidomos dijetarin e texhvidit, Shejkh Ramadan Dib.

Myftiu u lut për mbarësinë e teologëve dhe thirrësve, që kanë nisur të angazhohen me penën dhe letrën, në dobi të komunitetit besimtar.

Për të pranishmit u shpërnda libri “Lexoj dhe mësoj Kur’an”, si dhe numri i ri i gazetës “Udha Islame”, kushtuar Muajit Ramazan. Ndërkohë, pas faljes së namazit të akshamit me xhemat, të pranishmit kanë marrë pjesë në iftarin e shtruar nga Myftinia Shkodër.

## IFTARI ME IMAMËT DHE KËSHILLTARËT



**D**itën e enjte, më 3 korrik 2014, pas faljes së namazit të akshamit në xhaminë e Parrucës, imamët, këshilltarët dhe aktivistët e rinisë islame, janë mbledhur në iftarin tradicional që Myftinia Shkodër shtron me rastin e Muajit Ramazan.

Iftari ka mbledhur në sofrën e vëllazërisë dhe harmonisë islame imamët e qytetit dhe të fshatrave, të cilët kanë ndarë me njëri-tjetrin emocionet dhe kënaqësitë e ditëve të para të këtij muaj plot mirësi dhe begati.

Me këtë rast, imamët dhe këshilltarët janë uruar edhe me Myftiun e Shkodrës, duke uruar një Ramazan sa më të mbarë dhe të mbushur me sihariqe për punën e përbashkët në shërbim të Thirrjes Islame në qytetin e Shkodrës dhe përtej saj.

Tradita e shtrimit të iftareve në Muajin Ramazan ka nisur që nga ditët e para të këtij muaj dhe do të vazhdojë deri në përfundim të tij.



Imam Muhamed B. Sytari  
Myfti i Zonës Shkodër

## SHENJTËRIA E RAMAZANIT NË MESAZHET E NJË HYTBEJE...

**D**itën e djeshme, nëpërmjet hytbes së xhumasë, që mbajta në xhaminë e Dërgutit, dhashë disa mesazhe që lidhen me shenjtërinë e Muajit Ramazan, në një kohë dhe në një vend, ku fjala “shenjtëri”, “rregull”, “disiplinë”, “peshore”, “të drejta elementare” e të ngjashme, shpesh ndodh të fshihen si në heshtje nga realitetet e jetës së përditshme.

Unë mendoj dhe them se në një vend si yni, me një përqindje dominuese islame të popullsisë (por, edhe po të mos ishte kështu), institucionet lokale dhe vendore, duhet të jenë shumë të vëmendshme për të respektuar shenjtëritë dhe besimin e masës së gjerë, sidomos në raste festash fetare a momentesh kulminante në jetën e tyre, si Ramazani (në rastin konkret).

Nuk është i largët kujtimi i festimeve mbi njëmuajore që nisin në Shkodër (sikurse edhe në mbarë Shqipërinë), në prag të Krishtlindjes. Është e natyrshme dhe krejt normale që institucionet drejtuese të organizojnë aktivitete dhe të dëshmojnë gëzimin, për nder të besimtarëve të vet, prej të cilëve marrin edhe votat, ndonëse të gjithë së bashku jetojmë në një vend e shtet laik, i dalë nga një diktaturë ateiste e pashembull!

Krishtlindja është një ditë, por të gjithë jemi dëshmitarë të zbulimeve mbi njëmuajore, që e bëjnë qytetin të vezullojë nga llambushkat dhe ndriçimet e rrugëve, ku spikasin elementët kishtarë të festës. Krejt normale, brenda kornizës së ruajtjes dhe kultivimit të mëtejshëm të frymës së harmonisë dhe respektit të besimeve, sidomos aty ku ato kanë një prezenca më të madhe (si rasti i të

krishterëve katolikë, në Shkodër).

Ndërkohë, vjen Ramazani, një muaj i tërë, i mbushur me një shpirt dhe atmosferë shpirtërore dhe domethënie shumë më të rëndësishme se shumë ditë dhe festa të tjera fetare në Islam. Ndalem dhe hedh sytë përreth; asgjë! Nuk ka asnjë lëvizje të Bashkisë, Prefekturës, Këshillit të Qarkut, a institucioneve të tjera shtetërore, në drejtim të shfaqjes së respektit dhe nderimit për Muajin më të shenjtë të muslimanëve!? A nuk është e habitshme?

Nga këtu, kam shprehur dhe vazhdoj të ngrej zërin, me aq sa më takon, për të thënë se në kuadrin e bashkëpunimeve serioze dhe korrekte që ne kemi me institucionet lokale dhe vendore, nuk do të ishte utopike që rrugët e qytetit tim të ishin zbukuruar me fenerë e llampa ndriçuese, simbolikë e këtij muaji të shenjtë!

Nuk do të ishte aspak e habitshme, që Bashkia të ngrinte “çadra iftari”, në dy-tre skaje të zonave muslimane, në të cilat të ftoheshin nevojtarët dhe skamnorët për të ngrënë një vakt të begatë, nga një dorë bamirëse, për të cilën të gjithë kanë lëvizur dorën, për t’i dhënë të drejtën e pushtetit dhe drejtimit!

Nuk do të ishte aspak utopike, që institucionet dhe Drejtoritë Rajonale, të shpërndanin pako me ndihma ushqimore për familjet e varfra në nevojë, në prag të këtij Muaj të Begatë.

Është më se logjike që në Buxhetin e përvitshëm të Bashkisë, të ketë një fond të posaçëm për Muajin Ramazan, Muajin më të Shenjtë të muslimanëve të këtij vend.

Nuk do të ishte utopike, që me



rastin e këtij Muaj të Shenjtë, Prefektura të ndikonte me politika të posaçme për uljen e çmimeve, që njerëzit ta ndjenin realisht bekimin hyjnor në këtë muaj; muslimanë dhe të krishterë!

Nuk do të ishte utopike, që Këshilli i Qarkut në koordinim me Komunitat përkatëse, të ndërmerren një aksion për pastrimin dhe ndriçimin e rrugëve të fshatrave ku ka xhami, në të cilat, në çdo natë Ramazani besimtarë të shumtë shkojnë për të falur namazin e teravisë.

Më rastisi mbrëmë, të shkoj në fshatin Mes-Myselim, nga rruga mbi Urën e Kirit, që të çon në Bardhaj e prej aty për në destinacionin tim. Errësirë pa fund. Shkurre të shastisura, që desh hynin në xhamat e hapur të makinës, prej ku ajri karakteristik i zonave të gjelbëruara, përzier me freskun e mbrëmjes së vonë, hynin dhe na shoqëronin në mjetin tonë!? A nuk do të ishte me vend, që të paktën në prag të këtij Muaj, të kishte një përpjek-

je, qoftë edhe në bashkëpunim me Myftininë e Shkodrës dhe xhamitë e saj, për prerjen dhe sistemimin e këtyre shkurreve, për lyerjen e rrugëve dhe vijëzimin e tyre me të bardhë etj?

Nuk do të ishte utopike, që në Shkodër, për gjatë gjithë Ramazanit të ndjehej atmosfera e shenjtërisë së Ramazanit edhe jashtë xhamive, si një kujtesë që nuk mund të fshihet as nga politikat ateiste, as nga neglizhenca e hutimi, (për të mos thënë: ), as nga tendenca për të zhbërë thirrjen e shpirtit nga frika e mentaliteteve donkishoteske a komplekset islamofobe (o Zot, nuk dua ta besoj këtë të fundit, nuk është mirë të jetë kështu!), në emër të vlerave qytetare dhe si një dëshmi e paqimit me Zotin, të Cilit, iu kthye shpina dhe u mohua për më shumë se 23 vite!?

Nuk do të ishte aspak utopike, madje kjo është detyrim i institucioneve tona, tamam si detyrimi që i kanë ngarkuar vetes me fillimin e dhjetorit të çdo viti, a edhe shumë më shumë se dhjetori...

Në këtë mënyrë, do të ishte shumë domethënëse, që kur të dalim me fëmijët tanë nëpër rrugët e qytetit tonë të dashur, t'u themi herë pas here: "Babë, festohet, në nderim të besimit dhe vlerave të shpirtit, që na bëjnë të jemi më të mirë e më të afërt me njëri-tjetrin, në Shkodërlocen tonë të shtrenjtë!"

Këtë deshta të përcjell nëpërmjet hytbes së djeshme, teksa flisja mbi shenjtërinë e Muajit Ramazan dhe nevojën që ka ruajtja dhe përhapja e kësaj shenjtërie në raporte të drejta shoqërore, në një qytet, që jeton mrekullisht kuptimet e shprehjes: "realitet në kufi", ku çdo kufi duhet nderuar dhe respektuar...

## “KARVANI I BEREQETIT”, MBËRRIN SËRISH NË SHKODËR



**S**ikurse është bërë traditë prej shumë vitesh, Bashkia “Bajram Pasha”, në kuadër të bashkëpunimit me Bashkinë Shkodër dhe Myftinë e saj, ka organizuar edhe këtë vit një iftar vëllazëror, me rastin e Muajit të Begatë të Ramazanit.

“Karvani i bereqetit”, siç njihet ndryshe kjo iniciativë besimi dhe vëllazërie, mbërriti në Shkodër, për ta gjallëruar edhe më shumë jetën fetare në këtë muaj, ku spikasin sofrat e iftarit, tubimet vëllazërore, vaset e bashkëbisedimet me tematika të ndryshme fetare, emisionet televizive dhe radiofonike, shpërndarja e ndihmave për nevojtarët, promovimi i librave dhe botimeve të reja etj.

Për shkak të kushteve jo optimale të motit, këtë vit, iftari madh nuk u shtrua në sheshin e Parrucës, si vitet e tjera, por në Pallatin e Sportit “Qazim Dervishi”, që ishte mbushur me besimtarë të shumtë, që kishin ardhur me familjet dhe fëmijët e tyre, për t’iu bashkuar gëzimit të kësaj sofere bujare, në këtë muaj organizimi dhe gjallërimi të familjes muslimane.

Në emër të Myftinisë Shkodër, iftari u përshëndet nga teologu Arben Halluni, i cili bëri edhe një lutje, duke shprehur mirënjohjen dhe vlerësimet e Myftinisë Shkodër për këtë bashkëpunim të vyer, në rrugën e pasurimit të jetës islame në Ramazan.

Ceremonia u përshëndet edhe nga Kryetari i Bashkisë Shkodër, z. Lorenc Luka, që vlerësoi këtë bashkëpunim dhe uroi të pranishmit me rastin e këtij muaj të begatë.

Një fjalë përshëndetëse, ishte edhe ajo e mbajtur nga përfaqësuesi i Bashkisë “Bajram Pasha”, që vlerësoi vëllazërinë e dy popujve tanë, si dhe vullnetin e mirë të vëllazërve nga Turqia, për të ndarë gëzimin e këtij muaj me besimtarët muslimanë në Shkodër, Shqipëri dhe në shumë treva të tjera të Ballkanit.

Për të pranishmit, ishte përgatitur edhe një program artistik me ilahi dhe këndime të ndryshme fetare në gjuhën turke, shoqëruar me dhurata të këndshme për fëmijët dhe të rinjtë e pranishëm.

## "SHPORTA USHQIMORE E RAMAZANIT" PËR FAMILJET NË KALA TË DRISHTIT

**P**araditën e së hënës, më 14 korrik 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i shoqëruar edhe nga bashkëpunëtorë të tij, bëri një vizitë në kalanë e Drishtit, ku u takua me banorët e pakët që jetojnë aty, në kuadër të vizitave të Muajit Ramazan.

Myftiu dëgjoi nga banorët e kësaj lagjeje për kushtet e mjerimit, në të cilin ata jetojnë, pa ndihmë e pa përkrahje ekonomike, vetëm me një asistencë minimale prej 2.000 (dy mijë) lekësh të reja në muaj.

Banorët iu ankuan Myftiut edhe për kushtet e vështira, në të cilat fëmijët e tyre detyrohen të përballen me to, për të ndjekur arsimin, poshtë në fshatin Drisht.

Me rastin e Muajit të Begatë të Ramazanit, për 12 familjet muslimane, banuese në kala të Drishtit, u shpërnda "Shporta ushqimore e Ramazanit", si një mbështetje nga Myftinia Shkodër për këta banorë në kushte të vështira jetese.

Me këtë rast, Myftiu premtoi se Myftinia Shkodër do ta ndjekë më me prioritet situatën e këtyre familjeve dhe do të përpiqet maksimalisht të jetë pranë tyre, jo vetëm me rastin e festave dhe ditëve të shënuara fetare.

Me këtë rast, Myftiu vizitoi edhe



xhaminë, thajse të rrënuar të lagjes, ku shprehu hidhërimin e tij për veprimin amatoresk dhe tendencioz të ndërtuesve dhe projektuesve të Shtëpisë Muze, që qëndron mbi xhaminë dhe që ka marrë edhe nga vakëfi i saj, duke mos vënë asnjë dorë në restaurimin e kësaj xhamie të vjetër e të lashtë.

Myftiu theksoi, se nëse ky godinë do të kishte qenë një objekt kulti jo-musliman, drejtuesit dhe qeveritarët e kohës do të vraponin ta rikonstruktin, pa më të voglin dyshim!

Myftiu u angazhua se me mbarësinë e Zotit, shumë shpejt, do të nisë rikonstrukcionin e xhamisë, ndërtimi i minares së shkatërruar, rrethimi i vakëfit dhe rikëndimi i ezanit, në këtë zonë 100% muslimane.

## NDIHMA USHQIMORE PËR FSHATIN DOMËN

**M**e rastin e gjallërimit të Muajit të Begatë të Ramazanit, ditën e mërkurë, më 16 korrik 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, ka vizituar fshatin Domën, komuna Postrisë, ku ka marrë pjesë në shpërndarjen e ndihmave ushqimore për krejt banorët e fshatit, realizuar në koordinim me Fondacionin "Mirësia" dhe Fondacionin turk "Sadakataşi".

Me rastin e kësaj vizite, Myftiu ka uruar besimtarët e pranishëm me rastin e këtij muaj të madhërisëm, duke theksuar se Ramazani është muaji i solidarizimit me njerëzit në nevojë dhe i kontributeve, që muslimanët japin në ndihmë të njëri-tjetrit.

Në këtë vizitë, Myftiu ka inspektuar nga afër edhe xhaminë e re, e cila i është afruar përfundimit dhe pritët, që pas Ramazanit të zhvillohet ceremonia e inaugurimit të saj.

Myftiu, i shoqëruar edhe nga Drejtori i Fondacionit "Mirësia", z. Korab Kaja, imami i xhamisë Domën dhe vëllezërit turqë, kanë vizituar edhe një familje të varfër me jetimë, të cilës i është afruar një ndihmë të posaçme.

Me mbarësinë e All-llahut, Myftinia Shkodër, do të vazhdojë të shpërndajë ndihma të tjera ushqimore për familje të tjera skamnore, në qytet dhe fshat, në kuadër të Muajit Ramazan.

Myftinia Shkodër falënderon Fondacionin "Mirësia" dhe Fondacionin turk "Sadakataşi" për këtë mirësi të dëshmuar në këtë ditë të bekuar.



## ZEKATI, MYFTIU TAKON IMAMËT KRYESORË TË QYTETIT

**M**yftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, zhvilloi sot, të enjten, më 17 korrik 2014, një takim pune me imamët kryesorë të qytetit Shkodër, me të cilët diskutoi rreth domosdoshmërisë së nxitjes së frymës së dhënies së zekatit, si një ndër pesë shtyllat kryesore të Islamit.

Në fjalën e tij para imamëve, Myftiu theksoi se një ndër shkaqet e rënies së Islamit në vendin tonë, gjatë periudhës së prag-komunizmit, është pa dyshim edhe ndalimi i dhënies së zekatit nga tregtarë shkodranë, të cilëve, iu konfiskuan më pas pasuritë dhe u bënë shembull denigrimi për mbarrë shoqërinë.

Për këtë, kërkoi që e xhumaja e ardhshme të ketë si një nga dy temat e hytbes, dhënien e zekatit dhe nxitjen e besimtarëve për ta praktikuar dhënien e tij në mënyrë masive, në dobi të kategorive që e përfitojnë atë.

Myftiu u komunikoi imamëve edhe udhëzimin e KMSH në lidhje me këtë kërkesë, duke u bazuar te

konkluzionet e Kryesisë së KMSH dhe Këshillit të Teologëve në lidhje me dhënien e zekatit dhe nxitjen e tij.

Gjatë këtij takimi, u diskutua edhe për rritjen e aktivitetit fetar në të gjitha xhamitë e Shkodrës në 10 ditët e ngelura të Ramazanit të sivjetshëm, për të përfituar maksimalisht nga bekimet e Zotit në këtë muaj adhurimi dhe kthimi nga dyert e besimit dhe adhurimit të pastër.

U diskutua shtimi i namazeve të natës dhe lutjeve për muslimanët në mbarë botën, sidomos në Gaza. Njëkohësisht, u caktua që ceremonia kryesore e Hatmes Sherife, do të zhvillohet ditën e mërkure, më 23 korrik 2014, pas namazit të iqindisë.

U lajmërua edhe shuma e sadekatul-fitrit për këtë vit, 300 (treqind) lekë të reja për person.

Në fund të këtij takimi, Myftiu i dhuroi imamëve një kopje të Kur'anit me përkthim të kuptimeve të tij në gjuhën shqipe, pjesë e një projekti bamirës.



ASNJËHERË NË JETË,

NUK DUHET

TË HARROJMË

MIRËSINË E ATYRE,

QË NA MORËN

PËR DORË

PËR T'NA NXJERRË

NGA ERRËSIRA

NË DRITË,

NGA PADIJA

NË UDHËZIM!



## “NATA E KADRIT, NATA E PËRKATËSISË SË SHENJTË ISLAME!”



**T**ë xhumanë, më 18 korrik 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, mbajti hytben e radhës në xhaminë e fshatit Bërdicë e Mesme. Në hytben e tij, Myftiu u fokusua te vlerat dhe rëndësia e Natës së Kadrit, si “më e mirë se një mijë muaj”.

Myftiu theksoi se Nata e Kadrit lidhet me rëndësinë e mbrojtjes së identitetit islam dhe përkatësisë fetare në jetë, pasi Kur’ani që zbriti në këtë natë të bekuar, i bën thirrje

**NË HYTBEN E KËSAJ  
XHUMAJE, HATIBI PËRSËRITI  
FAKTIN SE PËRKATËSIA  
ISLAME E SHQIPTARËVE KA  
QENË DHE DO TË JETË NJË  
GARANCI MË SHUMË PËR  
MBROJTJEN E TRADITAVE DHE  
VLERAVE KOMBËTARE**

njerëzimit të kthehen nga identiteti i tyre i besimit dhe përkatësia e fesë së pastër, që buron nga Krijuesi i universit.

Myftiu tha se përkatësia fetare ësh-

të e shenjtë dhe se Nata e Kadrit, në vetvete, ka për qëllim të forcojë këtë përkatësi të shtrenjtë, duke e forcuar muslimanin dhe besimtarin në fenë e tij, nëpërmjet adhurimeve të singerta dhe lutjeve për ta bërë të qëndrueshëm dhe të pathyeshëm në jetë, përballë sfidave të femohimit dhe devijimeve fetare.

Në hytben e kësaj xhumaje, hatibi përsëriti faktin se përkatësia islame e shqiptarëve ka qenë dhe do të jetë një garanci më shumë për mbrojtjen e traditave dhe vlerave kombëtare, si në të shkuarën dhe krejt historinë tonë, si dhe do të jetë një garanci për jomuslimanët, që përherë kanë jetuar të qetë dhe të respektuar nga muslimanët në vendin tonë.

Në hytben e kësaj xhumaje, Myftiu foli edhe për vlerat e zekatit dhe dobijtë shoqërore të dhënies së tij, duke kujtuar se e shkuara duhet të merret për bazë, sidomos kur shembujt e ndëshkimeve hyjnore, si pasojë e ndalimit të dhënies së zekatit, janë të shumta dhe të trashëguara në kujtesën tonë fetare dhe kombëtare.

U lajmërua edhe udhëzimi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, se sadekatul-fitri për këtë vit do të jetë 300 (treqind) lekë të reja.

## IFTARI I HARMONISË, QË BASHKON SHKODRËN ME PRIZRENIN...

**N**ë kuadrin e protokollit të binjakëzimit në mes Myftinisë Shkodër dhe Këshillit të Bashkësisë Islame Prizren, me ftesë të K.B.I. të Prizrenit, Këshilli dhe stafi i Myftinisë Shkodër, morën pjesë mbrëmë, më 18 korrik 2014, në iftarin e shtruar me këtë rast, në Prizren.

Tashmë, si një traditë e përvitshme, që nga nënshkrimi i protokollit të binjakëzimit në mes dy myftinive, më 15 tetor 2011, iftaret e ndërsjellta që bashkojnë këshillat e dy myftinive përkatëse, po kthehen në një mundësi më tepër për të rritur bashkëpunimin dhe afrimin në mes të dy qyteteve tona.

Gjatë këtij iftari, u vu theksi tek rëndësia e bashkëpunimit të institucioneve islame në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi dhe në krejt trevat shqiptare, si një kërkesë që buron nga zhvillimet e kohës dhe arritjet e bashkësive islame në trojet shqiptare.

Kjo frymë u refletua shumë mirë edhe në fjalën e rastit të mbajtur nga Kryetari i B.I. Prizren, z. Lutfi Ballek, si dhe në fjalën e mbajtur nga Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed Sytari.

Në iftar merrnin pjesë edhe Sekretari i Këshillit të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, z. Resul Rexhepi, Kryeimami i Ulqinit, Ali Bardhi, Myftiu i Kukësit, z. Islam Hoxha, Kryeimami i Rrozhajes, imamë dhe teologë të mirënjohur në trevat tona, deputetë, drejtues të KFOR në Kosovë etj.

Në fjalët e tyre përshëndetëse, u theksua gjithashtu se Muaji i Ramazanit është një mundësi shumë e mirë për të bashkuar kontributet e dobishme të muslimanëve shqiptarë në shërbim të Thirrjes Islame dhe përhapjes së vlerave islame në trojet tona.

# DRITË RAMA



# AZANI 2014



## IFTAR ME GAZETARËT DHE MEDIAT E SHKODRËS

**M**brëmjen e së xhumasë, më 18 korrik 2014, Myftinia Shkodër në koordinim me Radio "Jehona", mbledhi në një sofër iftari gazetarët dhe korrespondentët e mediave të ndryshme në Shkodër. Në mesazhin e tij para të ftuarve, përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni shprehu vlerësimet e Myftinisë Shkodër për kontributet e medias në shërbim të pasqyrimin të lajmit dhe korrektësisë në këtë drejtim, sidomos lajmet që lidhen me aktivitetin fetar në Shkodër.

Z. Halluni theksoi se Muaji i Ramazanit, është një mundësi më tepër që i shërben forcimit të frymës së bashkëpunimit dhe tubimeve në sofrat e iftarit, ku këmbehen mendime dhe ide të dobishme në shërbim të bashkëpunimit, harmonisë dhe mbarëvajtjes së komunikimit të ndërsjellët.

Të pranishëm në këtë iftar ishin drejtues, gazetarë dhe operatorë të mediave: Radio "Jehona", Radio "Zëri i Amerikës", Radio "Shkodra", "Radio-Televizioni Shqiptar", "Tv Top-Channel", "Tv1 Channel", "Tv Rozafa", "Tv Star Plus", "Tv Antena Nord", "Tv Kopluku", "Tv Lezha" etj.



## AKTIVITET FETAR PËR MOTRAT MUSLIMANE



**D**itën e shtunë, më 19 korrik 2014, Myftinia Shkodër organizoi një tribunë fetare për motrat muslimane, mbi vlerën dhe rëndësinë e Natës së Kadrit dhe namazit të natës në 10 ditët e fundit të Ramazanit.

Në ligjëratat e tyre, teologët Ferzet Ndoja dhe Jetmira Plaku, hodhën dritë mbi këto dy tema, duke u përqendruar tek ajetet kur'anore dhe hadithet e ndryshme, që nxisin përfitimin nga koha në shërbim të adhurimeve dhe lutjeve, sidomos në këto 10 ditë të fundit të Muajit Ramazan.

Në ligjëratat e këtij tubimi të begatë u theksua se Nata e Kadrit është më e rëndësishmja natë e jetës së një muslimani, që kërkon nëpërmjet saj pëlqimin dhe pranimin e Zotit. "Fakti që Nata e kadrit nuk na është treguar, ka një urtësi të madhe, që na bën ta mos përqendrohemi vetëm tek disa momente a një natë, por ta bëjmë traditë e zakon në jetën tonë adhurimin dhe lutjen, si të ishte secila natë, Natë Kadri" – theksoi vajza Ferzet Ndoja.

Ndërkohë, në ligjëratën e saj, vajza Jetmira Plaku, vuri theksin te vlerat e namazit të natës. Ndër të tjera, ajo theksoi se: "Namazi i natës është traditë e Hz. Muhammedit (a.s). Ai e praktikonte namazin e natës, si një urdhëresë kur'anore, me të cilën Zoti i gjithësisë desht ta udhëzonte zemrën e tij dhe ta mbushte me pëlqim dhe urtësi hyjnore. Prandaj, ta shfrytëzojmë kohën tonë për t'u afruar më shumë me All-llahun edhe nëpërmjet namazit të natës".

Për pjesëmarrëset në këtë aktivitet, Myftinia Shkodër shtroi një iftar.

## MIRËSITË E RAMAZANIT TROKASIN NË DYERT E MUSLIMANËVE NË VAU-DEJËS



**P**as drekën e së hënës, më 21 korrik 2014, Myftinia Shkodër mundësoi shpërndarjen e "Shportës ushqimore të Ramazanit" për 30 familje muslimane në Bashkinë Vau i Dejës.

I pranishëm në këtë vepër bamirëse, në këto ditë të Muajit Ramazan, ishte edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari. Në takimim e tij me besimtarët e pranishëm, Myftiu theksoi se Muaji Ramazan është një mundësi më shumë për t'u takuar me njëri-tjetrin dhe për të parë nga afër gjendjen dhe realitetet në të cilat jetojnë muslimanët në Zonën e Shkodrës.

Në fjalën e tij, Imam Muhamed Sytari theksoi: "Ne jemi muslimanë, kudo që të jemi, e kemi për detyrë fetare e morale që të ruajmë identitetin tonë, të dëshmojemi si njerëz ndërtues të urave të komunikimit më tjerët, edhe pse nuk janë si ne, si dhe të ruajmë vlerat tona islame të harmonisë dhe bashkëjetesës, duke respektuar njëri-tjetrin".

Myftiu shprehu kënaqësinë e tij për këtë takim dhe u lut për besimtarët muslimanë të kësaj zone, për mbarësi, shëndet, besim dhe ruajtje të vlerave islame, që janë njëkohësisht edhe tabani i vlerave kombëtare shqiptare.

Në fjalën e tij, Myftiu u angazhua se Myftinia Shkodër do të ndjekë me shumë seriozitet gjendjen dhe realitetet në të cilat jetojnë këto familje muslimane dhe se, me mbarësinë e All-llahut, ky ishte vetëm i pari i një sërë takimesh dhe detyrimesh që Myftinia Shkodër ka ndaj besimtarëve të vet në Bashkinë e Vaut të Dejës.

Po sot, "Shporta ushqimore e Ramazanit 1435", u shpërnda edhe për nevojtarë të fshatit Ganjollë, nën përkujdesjen e imamit të xhamisë, z. Erion Hasmeqaj.



## SHKODRA, PRIZRENI DHE ULQINI, NË IFTARIN E VËLLAZËRISË ISLAME

**D**itën e martë, më 22 korrik 2014, Myftinia Shkodër ka organizuar një iftar vëllazëror, për nder të Bashkësisë Islame të Prizrenit dhe asaj të Ulqinit.

Në iftarin e kësaj nate të begatë, ishin të pranishëm Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, Kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame të Prizrenit, Lutfi Ballek, Kryeimami i Ulqinit, Ali Bardhi, drejtues të shoqatave, medresesë, intelektuale dhe këshilltarë të tre myftinive.

Në fjalën e tij të rastit, Myftiu i Shkodrës, pasi uroi mirëseardhjen e vëllezërve nga Kosova dhe Mali i Zi, vuri theksin te rëndësia që kanë këto sofrat, në të cilat afrohen përherë e më shumë tri qytetet tona, por edhe shtohet mundësia e bashkëpunimit dhe solidarizimit të myftinive tona, në shumë drejtime.

Edhe Kryetari i B.I. të Prizrenit, Lutfi Ballek, pasi falënderoj Myftiun e Shkodrës për ftesën, konfirmoi se falë Zotit, po krijohen mundësitë që përherë e më shumë që të jemi më pranë njëri-tjetrit, sidomos me rastin e tubimeve fetare dhe Muajit Ramazan. Ai vlerësoi bashkëpunimin me Myftininë e Shkodrës dhe frymën e bashkëpunimit, sidomos në vitet e fundit.

Ndërkohë, Kryeimami i Ulqinit, Ali Bardhi, pasi uroi të pranishmit për agjërimin e deritanishëm, tha se Muaji i Ramazanit është një mundësi e mrekullueshme, që bashkon muslimanët dhe rrit interesimin e tyre për njëri-tjetrin. Ai tha se trevat tona, përherë kanë pasur një lidhje shpirtërore, të cilën e vazhdojmë edhe ne sot, me mbarësinë dhe bekimet e Zotit.

Pas iftarit, të pranishmit kanë falur së bashku namazin e akshamit në xhaminë e Parrucës.

## PLOTËSOHET ME SUKSES HATMEJA E RAMAZANIT 1435



**D**itën e mërkurë, më 23 korrik 2014, Myftinia Shkodër ka organizuar ceremoninë e përvitshme të plotësimit të këndimit të plotë të Kur'anit Famëlartë, gjatë Ramazanit të sivjetshëm.

Ceremonia e Hatmes, ka nisur pas namazit të iqindisë në xhaminë e Parrucës. Fillimisht, ceremonia ka nisur me fjalën e mbajtur nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili ka vënë theksin te rëndësia që ka prezenca e Kur'anit në jetën e muslimanit.

Myftiu ka kërkuar që Hatmeja Sherife, të mos përqendrohet vetëm në Ramazan, por të përhapet edhe pas Ramazanit, në të gjitha xhamitë e Shkodrës. Njëkohësisht ka shprehur gëzimin e tij, që këtë vit në Shkodër, leximi i plotë i Kur'anit është zhvilluar në shumë xhami, si; në Parrucë,

në Tophanë, në Rus, në Perash, në Golem etj.

Myftiu ka përmendur se muslimanët pa Kur'anin, janë të humbur, pa



bosht, pa udhëzim, pa dritë. Prandaj, ka kërkuar më shumë angazhim për ta bërë Kur'anin pjesë të jetës së përditshme, në mësim, lexim dhe mbi



të gjitha në veshje me moralin dhe shpirtin e tij për t'u dëshmuar si model i fesë islame në shoqëri.

Teologu Naim Drijaj, ka folur mbi rëndësinë dhe vlerat e Natës së Kadrit. Në fjalën e tij, imami i xhamisë Parrucë, është ndalur te disa dobi të kësaj nate, ku spikat shumëfishimi i shpërblimeve hyjnore për adhurimet e besimtarëve, falja e pakufishme nga Zoti i gjithësisë etj.

Më pas, imamët e nderuar të pranishëm në këtë ceremoni: Lavdrim Hamja, Idmir Plaku, Arben Halluni, Fejzi Zaganjori, Durim Kasemi, Bashkim Bajramtari, Naim Drijaj, Kujtim Cufaj, Fadil E. Kraja dhe Xhavit Sokoli, nën drejtimin e Myftiut, kanë vijuar në leximin e sureve të fundit të pjesës së tridhjetë, të cilat janë plotësuar me sukses, duke shënuar kështu edhe plotësimin e Hatmes Sherife.

Duaja e rastit është bërë nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, në të cilën është lutur për besimtarët dhe mirëqenien e tyre, për forcimin e muslimanëve në fenë e tyre, për ruajtjen nga sprovat e islamofobisë, për shtimin e begatisë në jetën tonë etj.

Një pjesë e kësaj lutje i është kushuar muslimanëve në Gaza, të cilët po përballën këtë Ramazan me kasaphanën më të frikshme të kohëve të fundit, nën heshtjen e ndërkombëtarëve, si pasojë e bombardimeve dhe vrasjeve të luftës, që po ushtron mbi ta ushtria izraelite. Lutje janë bërë edhe për muslimanët në Siri, Egjipt, Irak, Burma etj.

## MYFTIU: “RAMAZANI, MUAJI I BEKIMEVE MBI YMETIN ISLAM!”



**M**yftiu mbajti hytben e fundit të Imam Muhamed Sytari, mbajti sot në xhaminë e Parrucës, hytben e fundit të Ramazanit të sivjetshëm.

Fillimisht, Myftiu foli për mësimet e mëdha, me të cilat Zoti i gjithësisë i tregoi njerëzisë, në këtë muaj, se besimtarët me bindje dhe përkushtim në besimin e tyre, sado të pakët në numër e sado të braktisur nga bota që të jenë, do të kenë përherë mbarësinë dhe mbështetjen hyjnore.

Këtë, tha Myftiu, e pamë më së miri me vëllezërit tanë në GAZA, të cilët po bombardohen e po vriten në mënyrën më barbare nga ushtria izraelite, pa asnjë të drejtë!

Myftiu foli edhe për domosdoshmërinë e kthimit të muslimanëve nga Fjala e All-lahut, Kur'ani, si udhërrëfyesi dhe dritësuesi më i përsosur i jetës së njeriut. Myftiu pyeti: "Ku është sot Zeburi, Teurati, Inxhili? Ku janë origjinalët e tyre? Nuk janë më! Me këtë nuk dua të prek besimin as bindjen e të tjerëve, jo aspak, por dua të them se muslimanët, kudo që të jenë, duhet të ndjehen krenarë që Zoti e ka vulosur Kur'anin me vulën e paprekshmërisë! Kur'ani që lexojmë

sot, është i njëjti, që ka lexuar edhe Resulull-llahu (a.s), pa asnjë presje më pak! Prandaj, mos ta braktisim Kur'anin e mos të na shkojë jeta në injorancë, pa e shfletuar një herë Librin e All-llahut, për ta mësuar, për ta lexuar, e mbi të gjitha, për ta vënë në jetë!"

Myftiu falënderoi krejt imamët e Shkodrës, xhematet, shoqatat bamirëse, biznesmenët e kontribuuesit, ata që shtruan iftare vëllazërore, ata që dhanë zekatin dhe sadeka të ndryshme, mediat lokale për pasqyrimin serioz të aktiviteteve të këtij Ramazan, pjesëmarrësit në Hatmen e Kur'anit dhe krejt ata të rinj e të reja, që këtë muaj e dëshman veten e tyre si muslimanë të lidhur pas fesë së tyre, pa ndrojtje e paragjykim.

Myftiu përsëriti se shuma e sadekatul-fitrit për këtë vit është 300 lekë të reja për person, sikurse bëri të ditur se namazi i Fitër Bajramit do të falet në sheshin bri xhamisë “Ebu Bekër”, ditën e hënë, më 28 korrik 2014, duke nisur nga ora: 05.00, kur do të falet edhe namazi i sabahut me xhemat.

Hytben e plotë, mund ta ndiqni sot, në ora: 19.00, në Tv1 Channel.

"JU PATJETËR  
DO TË SPROVOHENI  
SI NË PASURINË TUAJ,  
SI NË VETËN TUAJ,  
MADJE DO TË DËGJONI  
OFENDIME TË SHUMTA  
PREJ ATYRE  
QË U ËSHTË DHËNË LIBRI  
PARA JUSH,  
E EDHE PREJ IDHUJTARËVE,  
PO NË QOFTË SE DURONI  
DHE RUHENI,  
AJO ËSHTË GJËJA  
MË VENDIMTARE."

KUR'ANI: 3:186.

## KRYETARI I BASHKISË SHTRON IFTARIN TRADICIONAL

**D**itën e xhuma, më 25 korrik 2014, Kryetari i Bashkisë Shkodër, Z. Lorenc Luka, ka shtruar iftarin e përvitshëm tradicional, në shenjë respekti dhe nderimi për Muajin e Begatë të Ramazanit dhe agjëruesit e tij.

Në këtë iftar merrnin pjesë drejtues të institucioneve të ndryshme të qytetit të Shkodrës, Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër, z. Maxhid Cungu, Kryetari i Këshillit të Bashkisë Shkodër, z. Bardhyl Lohja, antarë të Këshillit të Bashkisë, drejtues të shoqatave, medresesë, imamë e besimtarë.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Kryetari i Bashkisë Shkodër, z. Lorenc Luka, uroi përzemërsisht besimtarët muslimanë me rastin e Muajit Ramazan. Ai cilësoi se vullneti për të agjëruar është një cilësi e njerëzve besimtarë, që e duan Zotin dhe kërkojnë bekimet e Tij në jetë. Ai theksoi se tradita e shtrimit të iftareve, është një mënyrë shumë e mirë për të afruar përherë e më tepër njerëzit besimtarë, në tryezat vëllazërore të këtij Muaj.

Ndërkohë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, në fjalën e tij përshëndetëse, pasi e falënderoi Kryetarin e Bashkisë Shkodër për këtë traditë të bukur dhe me vlera, që e realizon prej vitesh, u shpreh se ky iftar është dëshmi e bukurisë së besimit dhe harmonisë që ai krijon në zemrat dhe botën e njerëzve, edhe në qytetin tonë.

Myftiu u lut për begatinë e Shkodrës dhe njerëzve të saj, si dhe për suksese të mëtejshme të Bashkisë Shkodër me të gjitha strukturat e veta.

## NJË IFTAR VËLLAZËROR ME KRYETARIN E KMSH, SKËNDER BRUÇAJ



**M**e ftesë nga Këshilli i Myftinisë Shkodër, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Skënder Bruçaj, ka marrë pjesë sonte, më 26 korrik 2014, në iftarin vëllazëror të shtruar nga Myftinia Shkodër në nder të kësaj vizite, natën e fundit të teravisë së këtij Ramazan.

Pas përshëndetjeve të përzemërta me pjesëmarrësit në këtë sofër bujare, Kryetari i KMSH, është interesuar për mbarëvajtjen e aktivitetit të Myftinisë Shkodër gjatë këtij muaj, duke theksuar se Komuniteti Mysliman i Shqipërisë e ka vlerësuar maksimalisht këtë muaj, duke dhënë mesazhet e besimit dhe humanizmit, nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme fetare, bamirëse, sociale, emisioneve të ndryshme televizive dhe radiofonike, sofrave bujare të iftarit etj.

Nga ana e tij, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, e ka falënderuar Kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Skënder Bru-

çaj, për këtë vizitë dhe pjesëmarrjen në këtë iftar vëllazëror, duke falënderuar njëkohësisht përkushtimin e shfaqur nga KMSH gjatë këtij muaj në shumë drejtime, në shërbim të vlerave islame dhe në rrugën e lartësisimit të Thirrjes Islame në vendin tonë.

Me rastin e këtij iftari, Myftiu i ka dhuruar Kryetarit të KMSH, një kujtim simbolik nga trashëgimia e hoxhallarëve të kaluar të Shkodrës, të bashkuar në një foto të përbashkët, me lutjet më të mira për mbarësinë dhe sukseset e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe misionit të tij.

Më pas, Kryetari i KMSH, i shoqëruar edhe nga mikpritësit, si dhe antarët e Kryesisë së KMSH, z. Genti Kruja dhe z. Uran Kalej, ka marrë pjesë në faljen e teravisë së fundit të këtij Ramazan, në xhaminë e Parrucës, ku është mirëpritur nga besimtarët e pranishëm, me të cilët është lutur për pranimin e këtij Muaj dhe adhurimet e tij.





## MESAZHI I MYFTIUT ME RASTIN E FITËR BAJRAMIT 1435/2014



**Të nderuar dhe të dashur besimtarë muslimanë,**

**N**ë prag të Festës së shënuar të Fitër Bajramit, më lejoni t'ju drejtohem me këtë urim të përzemërt, me shpresën dhe lutjet që All-llahu (xh.sh) me mirësitë e Tij, t'ju ketë pranuar adhurimet tuaja, agjërimin e Ramazanit, veprat e mira, rrugëtimin tuaj drejt virtyteve pafund, që burojnë nga Kur'ani dhe mësimet e tij.

Fitër Bajrami, është një tjetër station reflektimi drejt madhësisë së bashkëpunimit dhe forcimit të lidhjeve në mesin tonë, duke u dëshmuar një bashkësi e qytetëruar, me besim dhe cilësi të larta përkushtimi, që di të mendojë e të punojë për të mirën e vet dhe për të ardhmen e brezave që vijnë.

Fitër Bajrami është një mundësi tjetër, pas eksperiencës së mrekullueshme të Ramazanit, që na nxit përherë e më shumë drejt interesimit për njëri-tjetrin, për ekonominë, për besimin, për edukimin e fëmijëve, për ruajtjen e vlerave të vëllazërimit dhe harmonisë në mes vete, si muslimanë, që besojnë se ky shekull është shekulli i vlerave të vëllazërisë dhe harmonisë së pastër të besimit dhe dritës islame.

Fitër Bajrami është një mundësi më shumë, për të shtrirë duart e pajti-

mit dhe mirëkuptimit, për të lënë pas krahëve të kaluarën, sado e afërt a e largët që të jetë, në rrugëtimin tonë drejt një të nesërme më të mirë e më të begatë për ne, familjen tonë dhe shoqërinë ku jetojmë! Sepse, Zoti nuk e ndryshon gjendjen e një populli, përderisa ata nuk kanë vullnet për ta ndryshuar gjendjen e tyre!

Fitër Bajrami është mundësia e vështrimit me vëmendje në realitetet e përditshme dhe rrugëtimin tonë kulturor, edukativ e besimor. A është kjo rruga që Zoti do për ne, si muslimanë? A është ky morali i duhur, me të cilin po brumosen fëmijët tanë? A është heshtja e jonë, modeli islam i të jetuarit, përballë veseve, afetarizmit, islamofobisë? Jo, nuk janë!

Fitër Bajrami, me atmosferën e begatë të festës dhe të gëzimit me shpërblimet e Zotit, pas një muaji të begatë adhurimi e përkushtimi specifik, vjen pikërisht për të na dhënë këtë mësim të madh: All-llahu i Madhëruar, nuk ka nevojë për pamjen tonë, as për etjen a urinë, as për festën a adhurimin, por kërkon përkushtimin tonë në jetë, për realizimin e qenies sonë "mëkëmbësit e Tij" në tokë! Kur ta kuptojmë e ta veprojmë këtë mësim si duhet, atëherë do të jetë vërtetë Bajram i Madh për ne, për familjen tonë, për bashkësinë tonë besimtare, për mbarë shoqërinë tonë, në themelet e të cilës qëndron madhështia e mësimëve të Kur'anit dhe traditat e Hz. Muhammedit (a.s), me të cilat mburremi me të drejtë para kujtdo!

**Gëzuar e Për Shumë Vjet Fitër Bajramin!**

**Imam Muhamed Sytari**  
Myfti i Zonës Shkodër

Shkodër, më 30 Ramazan 1435/27  
korrik 2014



## FITËR BAJRAMI TEJMBUSH XHAMITË E SHKODRËS

**Q**ë në orët e para të ditës së hënë, më 28 korrik 2014, besimtarë të shumtë muslimanë, kanë nisur të mbushin xhamitë e Shkodrës, në përgatitje për faljen e namazit të sabahut dhe pjesëmarrjen në ceremonitë e Fitër Bajramit të këtij vit, që për shkak të paqëndrueshmërisë së motit, nuk u zhvillua në shesh.

Ceremonitë kryesore u zhvilluan në dy xhamitë qendrore të Shkodrës, në xhaminë “Ebu Bekër” dhe në xhaminë e Parrucës.

Pas faljes së namazit të sabahut në xhaminë e Parrucës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari ka marrë pjesë edhe në ceremonitë e zhvilluara në xhamitë e fshatrave Mes-Myselim dhe Bardhaj.

Në fjalën e mbajtur në xhaminë e Mes-Myselimit, Myftiu ka folur për rëndësinë e ruajtjes së identitetit të muslimanit në shoqërinë e sotme shqiptare. Ai ka kërkuar që muslimanët ta dëshmojnë veten e tyre nëpërmjet vlerave të besimit dhe cilësive të fesë islame, duke u bërë thirrës drejt madhësisë së saj.

Ndërkohë në xhaminë e fshatit Bardhaj, Myftiu ka uruar të pranishmit edhe për performancën e korit të xhamisë, që ka zbukuruar këtë ditë me programin e bukur ar-



tistik të mbushur me ilahi, recitime e përshëndetje të ndryshme. Myftiu është lutur për fëmijët dhe prindërit e tyre dhe ka uruar që ky Fitër Bajram të jetë një moment i rëndësishëm kthese në jetën e secilit.

Më pas, Myftiu ka marrë pjesë edhe në ceremoninë e xhamisë së Parrucës, ku ka mbajtur edhe ligjëratën e tij të posaçme të kësaj dite dhe më pas ka drejtuar namazin e Fitër Bajramit.

Në programin e ceremonisë së zhvilluar në xhaminë “Ebu Bekër”, teologu Lavdrim Hamja, ka mbajtur një ligjëratë mbi vlerat dhe rëndësinë e mësimëve islame në jetën e muslimanit, duke u përqendruar tek morali dhe sjellja e muslimanëve në jetë.

Ndërsa në hytben e Fitër Bajramit, imami i kësaj xhamie, teologu Idmir Plaku, ka vënë theksin te rëndësia që ka mbajtja e besës së agjërimit, duke u përqendruar te mbikëqyrja e Zotit në jetën e përditshme, drejt një perfeksionimi të adhurimit dhe lutjes.

Në xhaminë e Parrucës, më herët ka përshëndetur edhe teologu Arben Halluni dhe ka ligjëruar imami i kësaj xhamie, teologu Durim Kasemi, që është ndalur te vlerat e adhurimit dhe domosdoshmëria e ruajtjes së ritmeve të muajit Ramazan, edhe pas tij, në shoqërinë tonë.

Pas ligjëratës së Myftiut dhe namazit të drejtuar prej tij, hytben e Fitër Bajramit e ka mbajtur teologu Naim Drijaj, që pasi ka bërë urimet dhe përshëndetjet e rastit, është lutur për pranimin e agjërimit dhe ka nxitur përhapjen e gëzimit të kësaj feste në familje e në rrethet shoqërore.

Edhe këtë vit, në të gjitha xhamitë e Shkodrës, ka pasur një pjesëmarrje përtej kapacitetit që ofrojnë këto xhami.

Dita e Fitër Bajramit, është një festë që festohet në mbarë globin, duke dëshmuar harmoninë dhe vlerat e besimit.



## VIZITORË TË SHUMTË UROJNË FITËR BAJRAMIN



**D**itën e parë të Fitër Bajramit, më 28 korrik 2014, pas kryerjes së ceremonive të Fitër Bajramit, Myftinia Shkodër ka organizuar pritjen tradicionale të miqve dhe vizitorëve, me rastin e kësaj dite të shënuar në kalendarin e festave islame.

Myftiu dhe imamët e pranishëm, në ambientin e përgatitur enkas për vizitorët, në xhaminë e Parrucës, kanë pritur me përzemërsi vizitorët e ndryshëm, duke nisur nga drejtuesit më të lartë të institucioneve fetare të Shkodrës, drejtuesit e institucioneve vendore e lokale, deputetët, drejtuesit e shoqatave, intelektualët e besimtarët e shumtë.

Gjatë kësaj pritje, ra edhe një herë në sy, respektimi i festave fetare në Shkodër, si një gjurmë e traditës së respektimit të fesë dhe besimtarëve, sidomos në këto ditë, kur mbarë bota përkujton mirësitë e Fitër Bajramit.

Edhe në dersin e mbajtur me rastin e Fitrit, por edhe në pritjen e vizitorëve, Myftiu i Shkodrës ka theksuar se ky Fitër Bajram vjen më i gjakosur se kurrë, si pasojë e bombardimeve vrastare dhe krimeve ndaj njerëzimit, me të cilat izraelitët po sulmojnë e vrasin pa mëshirë, njerëz të pafajshëm, një popull heroik e qëndrestar si palestinezët, të cilëve pasi u kanë grabitur tokën, po u shkatërrojnë edhe pasuritë, pronat dhe mbi të gjitha po u marrin jetën!

Me rastin e kësaj dite, Myftinia Shkodër lutet që paqja dhe mëshira e Zotit të zbresë mbi Gaza, Siri, Irak, Egjipt, Burma, lokalitetet muslimane të Kinës, vendet islame të Afrikës dhe mbarë botën, ku muslimanët po persekutohen si asnjëherë tjetër në historinë e njerëzimit!



MYFTINIA SHKODËR  
FALËNDERON  
TË GJITHË IMAMËT,  
MUEZINËT, BESIMTARËT,  
STAFIN DHE TË RINJTË  
E SHUMTË,  
QË KONTRIBUAN  
QË KY MUJAJ  
I MADHNUESHËM  
I RAMAZANIT  
DHE CEREMONITË  
E FITËR BAJRAMIT,  
TË KALONIN NË KËTË  
ATMOSFERË  
TË MREKULLUESHME  
BESIMI  
DHE VËLLAZËRIE ISLAME!



# KANË FILLUAR REGJISTRIMET PËR HAXHIN E KËTIJ VITI

REGJISTRIMET PËRFUNDOJNË MË 1 SHTATOR 2014



PËR MË SHUMË, JENI TË MIRËPRITUR TEK ZYRAT E MYFTINISË SHKODËR

**Botues:**  
Myftinia Shkodër  
**Drejtues:**  
Imam Muhamed Sytari

**Dizajn & Grafik:**  
Bledar Xama

**Tel / Fax:**  
+355 (0) 224 2081  
**Nr. llogarie:**  
100054 UBA - Shkodër

**E-mail:**  
[udhaislame@myftinia-shkoder.org](mailto:udhaislame@myftinia-shkoder.org)  
**Website:**  
[www.myftinia-shkoder.org](http://www.myftinia-shkoder.org)